

**Skënderbeu në përmbledhjen “Razgovor Ugodni”
të poetit kroat Andrija Kaçiq-Miošiq
dhe kontributi i këtij në letërsinë epike të sllavëve jugorë**

I kushtohet Atë Zef Pllumit o.f.m.

Abstract: *Scanderbeg in the Pleasant Talk of Slavic People and the immense contribute of Fr Andrija Kačić-Miošić to the epic literature of the Southern Slavs.* Published first in 1756 and re-edited in 1759, *Razgovor ugodni slovinskoga naroda* remains to this day the most important work by Fr Andrija Kačić-Miošić. The title introduces the theme of folk songs and tales. However, in the second edition of this collection, among others, a large number of songs is devoted to Gjergj Kastrioti – Scanderbeg, a real historical figure.

Widely celebrated in the Venetian, Italian and Spanish territories, the figure of Scanderbeg became now very popular in the literature of the Southern Slavs as well – a debt largely owed to Kačić-Miošić.

The lecture attempts to focus on the reasons why Kačić-Miošić chose to bring Scanderbeg’s deeds alive. It also explores the events and the data that possibly rekindled and maintained high the interest of the Croatian poet in this prince and the resistance of the Albanians against the Ottomans.

Keywords: Razgovor Ugodni, Kačić-Miošić, Barletius, Scanderbeg, Castriota, Filip Lastrić Očevac, Albanian literature, Albanian stradioten, Zadar.

Botuar për herë të parë në 1756, përmbledhja me këngë “Razgovor Ugodni Naroda Slovinskoga” – *Bisedë e këndshme e popullit sllav* e poetit françeskan Andrija Kaçiq-Mioshiq, mbetet ende sot vepra kryesore që i dha këtij autori popullaritetin më të madh. Në këtë përmbledhje këngësh epike (botimi i dytë, i vitit 1759) hyjnë edhe shtatëmbëdhjetë këngë kushtuar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, kapetanëve që luftojnë me të, si edhe dy këngë kushtuar rrethimit të Shkodrës.

Kaçiq-Mioshiqi e shkroi “Bisedën” në mënyrë që “ta lexonin ata që nuk njihnin latinishten, fshatarët e varfër dhe barinjtë e popullit sllav”¹.

1 “Kačić je svoj Razgovor ugodni složio da ga čitaju latinskome novješi «siromaši težaci i čobani naroda slovinskoga»” tek: Vončina, Josip. „Kačić i Reljković na razmeđu epoha“,

Si një françeskan i mirë, u përpoq t'i gjendej pranë atyre që nuk kishin marrëdhënie me kulturën, me ata që gjendeshin jashtë kontakteve të drejtëpërdrejta me artin, letërsinë, historinë. Pikërisht ky parim e shtyu të përdorte një gjuhë, formë dhe stil letrar më të afërt me kroatishten e folur në Dalmaci, dhe si pasojë, më të kuptueshme për lexuesin e rëndomtë, por megjithatë, pa rënë në grackën e një gjuhe bajate. Bëhet fjalë, pra, për një përpjekje – e cila mund të themi se pati sukses – për të përhapur tema të larta nëpërmjet një tonaliteti gjuhësor të pranueshëm dhe të kuptueshëm. Shfaqet kështu tek ky poet synimi kryesor i iluminizmit katolik kroat.

Kaçiq-Mioshiqi shkruan letërsi në gjysmën e parë të shek. XVIII dhe gjendet në Zaostrog, mbasi ka studjuar në Osijek, Shibenik, Sumartin, Venedik etj. Por çfarë shkruajnë në këtë periudhë shkrimtarët kroatë, para Kaçiq-Mioshiqit, ose në kohën e tij?

Pejsazhi letrar kroat është mjaft i larmishëm në këtë shekull. Kultura venedikase, mbas shtytjes që i dha baroku, kishte sjellë në Dalmaci në shek. XVII shkrimtarët italianë si Tasso, Ariosto (me veprat e tyre si “Jeruzalemi i çliruar”, “Aminta”, “Orlandi i furishëm”) ku tema e mbrojtjes së fesë së vërtetë bashkëjeton me temën e dashurisë kalorsiake dhe me pastoralin. Gjejmë kështu edhe vepra pastorale si “Dubravka” e Ivan Gunduliqit. Në fund, pastaj, prap, gjejmë Goldonin dhe teatrin e tij por edhe Molierin, në disa përkthime. Vihen në skenë po ashtu edhe pjesë teatrale me tema fetare².

Papritmas, Kaçiq-Mioshiqi sjell në letërsinë kroate, poezinë popullore, pikërisht atë që i ka rrënjët në Bosnje. Autori duket se i thotë lexuesve se nuk ka nevojë të flasësh italisht apo të njohësh latinishten që të ndriçosh mendjen e njerëzve të zakonshëm. Heronjtë, nëpërmjet folklorit, jetojnë në kujtesën kolektive. Kanë emra dhe mbiemra dhe kështjellat, apo rrënojat e tyre, gjenden prap aty ku ka qenë gjithnjë. Toponomia është e pasur me emërtime që sjellin në kujtesë bëmat e këtyre heronjve. Mjafton që kujtimi i tyre të nxirret në dritë dhe ja, edhe sllavët e jugut do të ketë heronjtë e tyre që nuk mbesin prapa atyre të Tasso-s apo të Ariosto-s. Në fakt, luftrat e vazhdueshme në Ballkan kundër turqve osmanë nuk bëjnë gjë tjetër veçse nxisin për një çlirim përfundimtar të këtyre popujve nga sulltani. Nevojiten pra heronj. Por që heronjtë të jenë të tillë, duhet të jenë të pathyeshëm dhe të panjollë. Lexuesit e kohës vlerësojnë fitoren dhe kjo fitore duhet të jetë e përgjithshme: në fushën ushtarake, politike, por edhe atë ideologjike/fetare dhe morale, aq më tepër pastaj nëse shkrimtari është një rregulltar françeskan si Kaçiq-Mioshiqi. Lexuesi nuk vlerëson heronjt, sado fisnikë

Razgovor Ugodni Naroda Slovinskoga, Andrija Kačić-Miošić – Satir ili divlji čovik, Matija Antun Reljković, priredio Josip Vončina, Zagreb, 1988, fq. 10.

2 Muraj, Lada. “Dva lica kučnoga kazališta u Dubrovniku u 18. stoljeću”, in *Croatologija* 1(2010) 1, fq. 191.

që mund të jenë, të cilët humbasin në fushën e betejës. Për këtë tipologji heronjsh letërsisë botërore iu desh të priste personazhet e Hemingway-it.

Në të vërtetë, shkrimtarët kroatë i kishin kërkuar me kohë në veprat e tyre heronjt, edhe para “Bisedës së këndshme”. Fjala vjen, gjejmë “Osman”-nin e Ivan Gundulić-it, frymëzuar nga temat e “Jeruzalemit të çliruar”, në këngën e tretë të të cilit përmendet edhe Gjergj Kastrioti. Këtu duhet shtuar se, ndonëse kjo vepër u botua për herë të parë vetëm në 1821, dorëshkrimi është i vitit 1651.

Edhe Ivan Tomko Mrnavić shkruan për të thyerit e turqve në Hoq dhe i kushton kësaj ngjarjeje një dramë me pesë akte “Osmanščica” (1631);

Petar Bogašinović shkruan për rrethimin e Vjenës “Beča grada obkruženje od cara Mehmeta i kara-Mustafe velikog vezjera”, (1684) botuar në Linz, ku iu këndon bëmave të Francesco Gundulić-it, të birit të tij Giovanni Gundulić-it dhe Jan Sobieski-t;

Pavao Ritter Vitezović shkruan veprën “Bosna Captiva sive regnum et interitus Stephani ultimi Bossnae regis, Tyrnaviae” (1712) - por kjo e fundit është më tepër një traktat politik sesa letërsi. Në të gjitha këto vepra sundon tema e dashurisë ndaj atdheut. Po i njëjti autor shkruan edhe një *carmen* latinisht me titullin “Novus Skenderbeg” (1682), ku i bën elozhe Pietro Ricciardi-t, kont i Likës, për trimëritë dhe fitoret e tij në luftë.

Nga ana tjetër, edhe në folklorin sllav jetojnë figura heronjsh siç është Marko Kraljeviq, për shembull. Bëmat e tij janë shumë të njohura në popull. Këndohen dhe përcillen brez pas brezi, ashtu siç janë mjaft të njohura edhe këngët e ciklit epik të betejës së Kosovës. Megjithatë, ky personazh duket se nuk i plotëson kërkesat që ka poeti Kaçiq-Mioshiq për heronjtë e tij. Marko Kraljeviq është më tepër një kalorës i vetmuar sesa një udhëheqës i masave të mëdha dhe i ushtrive të mëdha. Nuk është një burrë shteti. Dhe është pikërisht kjo tipologji heronjesh, e ngjashme me Tankredin dhe Orlandin, të cilën autori ynë përpiqet ta shmangë me çdo kusht.

Përmbledhja “Razgovor Ugodni” nuk është vetëm letërsi. Poeti e koncepton atë edhe si një manifest të lirisë aq shumë të lakmuar, të plotë dhe të pakusht të të krishterëve në Ballkan. Ja pse autori ynë nuk ia falë Marko Kraljeviqit punën që për të shtënë rishtas në dorë principatën e të et, iu nënshtrua dhe i pagoi haraç sultanit³. Për më tepër dashuriçkat e Markos me çupën arabe⁴, mbase nuk i shkonin për shtat një kalorësi të krishterë, ashtu siç e konceptonte këtë tipologji personazhi Kaçiq-Mioshiqi.

Në këtë pikë, krijohet përshtypja se vëmendja e poetit përqendrohet

3 “I ovo je oni Marko Kraljević koga riščani za velika drže i od njega svakojake pisme izvode, koji želeći imat države otca svoga ne može učiniti drugo nego podložiti se caru i davati mu arač”, Vončina, vep. cit. fq. 38.

4 Tommaseo, Niccolo. *Canti popolari serbo-croati*, prefazione di Gheorghe Carageani, Sansoni editore, Firenze 1992, fq. 181.

tek Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ky duket se bën pikërisht për synimet e shkrimtarit. Skënderbeu, përveç se është një udhëheqës politik dhe ushtarak, është edhe një hero i pathyeshëm, *Athleta Christi*, siç e quan ai veten në letrat e tij. Është një hero që gëzon famë të jashtëzakonshme në Europë dhe morali i krishterë i tij (dhe i ushtrisë së tij) është i panjollë, po të gjykojmë nga mënyra si shprehet për të Marin Barleti⁵.

Ka pastaj edhe hollësi tjera që e rrisin dallimin ndërmjet Kastriotit dhe Marko Kraljeviqit. Për shembull, kur në njërën prej këngëve popullore, ky kalorës përgatitet të shkojë në një dyluftim kundër Musë Arbërorit, Marku ia cungon dorën kovaç Novakut sepse ky i ka farkëtuar një shpatë të mirë Musës⁶. Siç shihet nga kjo fabul, në këtë këngë Kraljeviqi shfaq ndjenja si lakmia, cmira, zemërimi e ndoshta edhe frika. (Rreth temës së shpatës pastaj, e cila na sjell jehonën e shpatës së famshme Durlindana të Orlandit të Furishëm, do të flasim më tej.) Françeskani ynë ishte në kërkim të figurës së një heroit që nuk bënte kompromise, të një hero i cili duhej të shprehte triumfin e plotë të krishtërimit në luftën kundër osmanëve, atë triumf që françeskanët e kishin mbështetur dhe nxitur ngaherë dhe për të cilin Kaçiqi ishte i ndërgjegjshëm.

Mendoj se kjo është arsyeja e vërtetë që e bëri autorin kroat ta zgjeronte numrin e këngëve kushtuar ciklit të Skënderbeut në botimin e dytë. Kjo është tipologjia e heroit që poeti kërkonte, jo ajo e Tankredit apo e Orlandit, heronj këta që shpesh bien prë të krizave të brendshme psikologjike.

Burimet historike nga të cilat poeti mori materialin për këngët e ciklit të Skënderbeut

Trokiti kësisoj Skënderbeu në letërsinë e iluminizmit katolik kroat si mishërim i idealeve të luftës kundër tiranisë. Pikërisht ky autor që i pari që e solli fuqishëm Skënderbeun në letërsinë kroate, në një kohë kur në territoret venedikase, spanjolle e prap pastaj në Portugali, Francë, Gjermani e tjetërkund Gjergj Kastrioti dhe bëmat e tij njiheshin gjerësisht dhe ishin përjetësuar prej kohësh tashmë në poezi, teatër⁷ e në muzikë. Ndërsa në historinë kroate, Skënderbeu kishte hyrë më parë, që me ipeshkvin boshnjak Ivan Tomko Mërnaviq (1631)⁸. Pikërisht, duke iu përgjigjur këtij,

5 "Nō scorta militaria nō aliquod (ut fit) eius lasciuię ueftigiū in castris unq Scanderbegi uisum." Barletius, Marinus. *Historia de vita et gestis Scanderbegi, epirotarum principis*. Bernardino Vitali, Roma 1508. Liber nonus, CX.

6 "Marco e Musa", in *Canti popolari serbi e croati scelti e tradotti da P. Kasandrić*, Carabba editore, Lanciano 1923.

7 Neziri, Zeqirja. *Lik Skenderbega u djelu Andrije Kačića-Miošića*, magistarska radnja, Filozofski Fakultet, Zagreb 1981, ff. 79; 81-84.

8 Po aty, Bilješke, 1.

Frang Bardhi shkruan apologjinë e Skënderbeut⁹.

Në botimin e parë Kaçiqi i kushtonte Skënderbeut vetëm dy këngë, më saktësisht: 1) *Pisma od Jure Kastriotića, pridiivkom Skanderbega, i njegove majke Vojsave*; 2) *Pisma druga od Jure Kastriotića*. Kjo gjë ndodhi ngaqë autori që i detyruar ta kufizonte numrin e përgjithshëm të këngëve për shkak të mungesës së mjeteve financiare¹⁰. Në këtë botim pohon se të dhënat historike i ka marrë “iz različiti kniga talianski” – *nga libra të ndryshëm në italisht*¹¹. Tri vjet më vonë, në botimin e dytë (1759), poeti ynë thotë se e ka zgjeruar fushën e tij të studimeve historike. Kështu, në këtë botim të dytë, ai citon edhe burimet nga ka marrë të dhënat për këtë përmbledhje më të zgjeruar këngësh epike dhe thotë: “*A to ja sam sve pomljivo izvadio iz knjiga latinski, talijanski i rvatski, iz različitih pisama i karata, diploma, dukala i atestata, davorija i svidodžbe staraca, redovnika i svitovnjaka*”¹².

Që t'i biem shkurt, bëhet fjalë për burime historike të cilat lexuesit e thjeshtë nuk kanë mundësi t'i njohin e t'i konsultojnë.

Përsa i përket burimeve në latinisht, padyshim që i referohet burimit parësor, domethënë “*Historia de Vita et Gestis Scanderbegi Epirotarum Principis*” të Marin Barletit e cila, mbas shumë botimeve, më në fund, ishte shtypur edhe në Zagreb me një titull mjaft domethënës: “*Vita, et res praeclare gestae Christi athletae Georgii Castrioti, Epirotarum principis, qui propter heroicam virtutem suam a Turcis Scander-beg, id est Alexander Magnus cognominatus est, libris XIII / a Marino Barletio, scodrensi sacerdote conscripta.*” (1743). Pra, ky botim i mbramë i Barletit pati dalë në Zagreb vetëm trembëdhjetë vjet para botimit të “*Bisedës*”.

Përsa i përket burimeve në gjuhën italishte, sigurisht që ka marrë nga autorët më se të njohur si: Sagredo, Biemmi, Doglioni; për ato në “*rvatski*” – në *kroatisht*, dihet me siguri se ka marrë të dhëna nga Filip Grabovac, françeskan edhe ky, shok studimesh i Kaçiqit si edhe ish-guardjan i kuvendit françeskan në Zaostrog. Në fakt, ky i fundit, në veprën e tij “*Cvit razgovora naroda i jezika iliričkoga aliti rvačkoga*” (Venedik, 1747) – *Lule [të zgjedhura] të bisedës së popullit e të gjuhës ilirishte, e quajtur ndryshe*

9 Georgius Castriottus, *Epiensis vulgo Scanderbeg, Epirotarum princeps Fortissimus, ac invictissimus Suis & Patriae restitutus*, per Franciscum Blancum, Venetiis, typis Marci Ginammi, 1636.

10 Perillo, Francesco Saverio. “Andrija Kačić-Miošić i povijest.” tek *Fra Andrija Kačić Miošić i kultura njegova doba: zbornik radova sa znanstvenog skupa Fra Andrija Kačić Miošić i kultura njegova doba*, održanoga 3. - 7. studenoga 2004. u Zagrebu, Sinju, Makarskoj, Mostaru, Bristu i Zaostrogu, Hrvatska akademija znanosti i umjetnosti, Zagreb 2007, fq. 12.

11 Vončina, vep. cit., fq. 26.

12 “Dhe unë gjithçka nxora me kujdes nga libra në latinisht, italisht dhe kroatisht, nga letra e karta të ndryshme, diploma, dekrete dhe vërtetime, nga këngë trimash dhe dëshmi të moshuarve, rregulltarëve dhe laikëve.” Po aty, fq. 23.

kroatishte, Grabovaci tregon në rend kronologjik disa nga ngjarjet e Arbërisë dhe të Skënderbeut¹³.

Megjithatë, kur në fund të këngëve të tij Kaçiqi pohon shpeshherë se këto, apo ato të dhëna i ka marrë nga ky e nga ai autor, tregohet i kujdesshëm mos ta përmendë kurrë Grabovacin, i cili ndërkaq i kishte humbur huret që gëzonte pranë Shumë të Kthjelltës Republikë aq sa ishte internuar dhe vitet e fundit të jetës i çoi në ishullin Santo Spirito, në Venedik.

Në fund, duhet të themi se Kaçiqi na pohon se ka marrë informacion edhe nga arkivat e rregulltarëve. Lind pyetja, të çfarë lloji mund të kenë qenë këto dokumente që ruheshin nëpër arkivat e françeskanëve dhe a kishin të bënin me ngjarjet e Skënderbeut, me ato të arbërve dhe kryengritjet e vazhdueshme kundër osmanëve?

Lajmet nga territoret që iu ishin nënshtruar osmanëve

Françeskanët edhe kleri tjetër i Dalmacisë, kishin qenë gjithmonë në kontakt me Arbërinë, e cila asokohe quhej edhe *Epirus Nova*. Kështu e quanin edhe letrarët e mesjetës. Mjafton të përmendim Frang Bardhin dhe fjalorin e tij *Latino-Epiroticum* (1635).

Që nga katërqindëshi, Durrësi, Ulqini, Tivari dhe vetë Shkodra bëjnë pjesë në Kustodjen Raguziane, një nga katër kustodjet që përbënin Provincën françeskane të Dalmacisë¹⁴.

Prof. Vonçina ka vënë në dukje se, kur Kaçiqi pohon se Starac Milovani – *Plaku i Urtë Milovan*¹⁵, i ka dëgjuar dhe i ka mbledhur këto këngë kur udhëtonte “od Skadra do Zadra, od Mostara do Kotora” – nga Shkodra në Zarë, nga Mostari në Kotor, ai i ka renditur këto qytete në vargje vetëm për efekt të rimës dhe jo për të treguar një hapsirë gjeografike ku këndoheshin këto këngë.

Nga ana ime dëshiroj të shtoj se këto katër qytete mbase nuk përputhen me hapsirën gjeografike ku vegjëlja e mbante gjallë kujtimin e heronjve por gjithsesi përkojnë, pak a shumë, me kufijtë e provincës françeskane të Dalmacisë, pra edhe të kuvendeve françeskane. Po ashtu, nuk mund të përjashtojmë me siguri se Atë Andrija Kaçiq-Mioshiqi nuk ka qenë kurrë në këto katër qytete. Atë Karlo Eteroviq është i mendimit se poeti, gjatë pushimeve të tij si profesor, udhëtonte dhe me shumë mundësi ka shkuar

13 Matić, Tomo. (priredio), *Cvit razgovora naroda i jezika iliričkoga aliti rvačkoga*, Jugoslavenska Akademija znanosti i umjetnosti, Zagreb 1951, fq. 220; 262-269.

14 Fabianich M.O., padre Donato. *Storia dei frati minori dai primordi della loro istituzione in Dalmazia e Bosnia*, vol. I, Zara 1863, fq. 145.

15 Kështu quhet rapsodi, një personazh fiktiv, i cili tek “Biseda” këndon këngët e shkruara nga Kaçiqi. Milovani u bë aq i dashur për lexuesit sa që këta nisën ta quanin vetë poetin me këtë emër.

deri më në jug, deri në bregdetin arbëror – “a po svoj prilici i dalje k jugu po arbanaškoj obali”¹⁶. Poeti Kaçiç na jep edhe një përshkrim pikërisht të kësaj zone kur flet për Zetën e Balshajve.

Nga ana tjetër françeskanët arbër janë të pranishëm në Dalmaci ashtu sikurse edhe ata dalmatë në Arbëri. Kuvendi françeskan në Bribir në Kustodjen e Zarës u pat shenjtëruar që në fillimet e tija nga “*vdekja e lavdishme e frat Andresë nga Arbëria i cili që i denjë të përmendet në aradhet e të lumëve për mrekullitë e shkëlqyeshme që kreu në mesin e atyre banorëve*”¹⁷. Madje deri edhe më në veri, në Istrije, ndonëse nuk përfshihet në Provincën Françeskane të Dalmacisë, gjejmë një tjetër frat, Mikel Arbërorin, varrosur në Cherso, shoq jete të rreptë e pendestare i fratis tjetër arbëror Gjon Buka¹⁸.

Fretërit e Arbërisë dhe të Arbërisë Venedike janë gjithnjë në kontakt me ata dalmatë. Madje, fretërit dalmatë e kanë takuar edhe personalisht Skënderbeun. Kështu, gjejmë se françeskani Gjon Arbërori bashkë me dy fretër dalmatë, dërgohet në Arbëri nga eprori i tij, Marino da Siena, për t’i dorëzuar Gjergj Kastriotit ndihmat në para që ishin grumbulluar në territoret e Venedikut për të¹⁹.

Më vonë, pastaj, papë Leoni X (1513-1521) dërgon në kuvendin françeskan të Zarës – për të cilin do të flasim më gjerësisht – Atë Bernardinin nga Shkodra, si nunc dhe komisar të Selisë Apostolike për të vigjëlur mbi moralin e besimtarëve të Bullgarisë, të Arbërisë dhe të Rashës²⁰.

Rregulltarët në Dalmaci janë të informuar rreth historisë dhe për gjithçka që ndodh në territoret ku tashmë sundon ligji i sulltanit. Kështu, në 1610, Marin Bici, kryepeshkëv i Tivarit, i cili vetë ishte arbër në zanafillë dhe pinjoll i një familjeje të kamur në Arbë²¹, viziton Malin e Zi, Arbërinë dhe Serbinë. Ky në relacionin e tij flet, mes tjerash edhe për vuajtjet e kishës katolike nën sundimin osman. Prap, vetë imzot Bici i kërkon Atë Antonit nga Shibeniku të vizitojë banorët e Kelmendit²².

Siç dihet, françeskanët përpiqeshin për të përhapurit e ungjillit por

16 Eterović, Fra Karlo. *Andrija Kačić Miošić na temelju novih istraživanja*, Dubrovnik 1922, p. 32.

17 “Breberii custodiae jadertinae jacet frater Andreas Albanensis qui post mortem in ipso meridie nullo ex custodibus vidente, apparuit duos captivos, qui illum invocarunt, eosque a vinculis et carcere, januis et compedibus illaesis, liberavit.” Fabianich, vep. cit., ff. 29, 36.

18 “Chersi iacet frater Michael albanensis virtutibus et pietate clarus, fuit socius in austeritate et peregrinatione fratris Joannis de Buca albanensis.” Po aty, fq. 36.

19 Po aty, fq. 204.

20 Po aty, fq. 247.

21 “[...] Marino Bizza di ricca e nobile famiglia d’Arbe, oriunda d’Albania, dove in quell’epoca possedeva un vasto patrimonio [...]” po aty, ff. 321-324.

22 Po aty, fq. 326.

edhe për lirinë e kultit dhe të të krishterëve nga osmanët. Në motet e luftës së Kandies (1645-1669), kryepeshkvi i Shkodrës atë Gregorio Frascina da Novara përgatit një kryengritje të arbërve të veriut²³. Kryengritja dështon dhe dy françeskanë italianë Giacomo Zampa da Sarnano dhe Ferdinando Isola da Albissola përshkohen në hell më 28 shkurt 1648 në pazarin e Shkodrës, bashkë me priftin arbëror Gjergj Jubani. Ndër dokumentet tjera që gjenden në fashikullin e martirizimit të tyre ka edhe një dëshmi të Antinore Durastante-s, kapiten dhe qeveritar ushtarak i Splitit²⁴. Lajmi, pra, kishte marrë dhënë dhe kishte mbërritur edhe në Dalmaci.

Por edhe françeskanët dalmatë nuk janë më pak guximtarë. Kështu, osmanët shkojnë në hell edhe Fra Mikelen nga Primorie në Makarska. Lajmin na e përcjell Leonardo Foscolo, proveditor i përgjithshëm i Dalmacisë dhe i Arbërisë, nga Zara, më 8 korrik 1650, pra vetëm dy vjet pas martirizimit të klerikëve në Shkodër²⁵. Edhe në Zaostrog, i cili është kuvendi ku vite më vonë do të jetonte e do të vdiste Kaçiqi, françeskanët ndihmojnë katër mijë familje të krishtera të shpërngulen nga territori osman dhe më pas i shpërndajnë në qytetet e ndryshme të Fort së Kthjelltës Republikë²⁶, siç vijon në dëshmitë e tij Atë Antonio Lulich²⁷.

Disa vite më vonë, pastaj, më 26 shtator 1689, turqit arrijnë të futen në Kullën e Norinos, siç na rrëfen *Chronicon Conventis Zaostrogensis*, dhe i presin kokën Atë Bonaventurë Vardausheviqit; vrasin atë Giuseppe Tvrtkoviqin, Atë Matteo Nanjanoviqin dhe Atë Pietro Matiçin, të gjithë këta nga kuvendi i Zaostrogut, të cilët ndihmonin të shpërngulurit që ishin strehuar në këtë kullë²⁸.

Vetë etërit e Zaostrogut, në nëntor të 1690-ës bashkëpunuan shumë në marrjen e fortesës turke të Vergoracit, ku u dallua ndër tjerë Atë Paolo Kaçiq-Barishiqi²⁹.

Të gjitha këto dëshmi, poeti Kaçiq-Mioshiq me siguri i ka lexuar nëpër arkivat e kuvendeve të ndryshme françeskane. Emrat e françeskanëve që kishin vdekur si martirë sigurisht që lexoheshin kur bashkësitë e rregulltarëve hanin drekën e darkën në tryezën e përbashkët. Kështu,

23 Po aty, fq. 347.

24 Sella, Pacifico. Testimonianze inedite circa il martirio dei frati minori Giacomo da Sarnano e Ferdinando da Albissola, *CARTHAGINENSIA*, VOL. XXXI, 2015, ff. 1059-1076.

25 Lulich, padre Antonio. *Stato della Dalmata Francescana Provincia del MM. OSS del SS Redentore*, Spalato 1857, ff. 10-11.

26 Lulich, vep. cit, shënimi 3, fq. 11.

27 Nuk e kemi të mundur të gjejmë nëse vetëm disa nga këto familje apo të gjitha ishin nga Arbëria [apo nga Albania Veneta], siç i ka interpretuar këto rreshta historiani Atë Marin Sirdani o.f.m., krhs. Hylli i Dritës 1940, nr. 12, ff. 591-592.

28 Lulich, vep. cit, fq. 12.

29 Po aty.

kujtimi i atyre që kishin vdekur nga dora e osmanëve ishte gjithmonë i gjallë. Ndeshjet e vazhdueshme të popujve të Ballkanit me pushtetin e osmanëve nuk bënte gjë tjetër veçse e mbante të gjallë kujtimin e trimave që kishin arritur ta ruanin lirinë e këtyre popujve, shembull i fortë i të cilëve ishte Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Mbërritja e valës së parë të arbërve në Zarë në 1726 dhe lajmet e një tjetër kryengritjeje të arbërve në 1737, kësaj here në Kelmend, të cilët qenë të shtrënguar të shpërnguleshin nga alpet arbërore në territoret kroate, në Sllavoni³⁰, janë një tjetër dëshmi e këtij shpirti të paapur dhe të kësaj nevoje për liri.

Kaçiq-Mioshiqi në poemat e tij nuk ngrente thjeshtë në qiell një brez prijsash fitimtarë, por nxiste që të lindte një tjetër hero, i cili, si Skënderbeu, t'i mundte përfundimisht osmanët.

Kaçiq-Mioshiqi në Zarë, ngjarjet e luftës së Kandies dhe stratotët arbër

Studime të shumta rreth letërsisë kroate që më është dhënë mundësia të konsultoj, mes të cilave edhe vetë *Hrvatski Biografski Leksikon*³¹, nuk e përmendin faktin se Atë Andrija Kaçiq-Mioshiqi ka qëndruar edhe në Zarë, jo shumë larg nga kjo seli universiteti ku po mbahet kjo konferencë shkencore. Kjo ndodh sepse ka shumë boshllëqe në biografinë e poetit françeskan. Megjithatë, provinca françeskane dalmate ka mbajtur shënim gjithçka në regjistrat e saj. Kështu, në listën e françeskanëve që kanë dhënë mësim jashtë provincës del edhe: "Padre Andrea Cacich-Miossich da Brist di Macarsca Lettore Generale in Brescia e al seminario arcivescovile di Zara." – *Atë Andrea Kaçiq-Mioshiqi, nga Bristi i Makarskës Lektor i Përgjithshëm në Brescia dhe në seminarin e Zarës*.³²

Çështja është të përcaktojmë se kur ka qëndruar këtu Atë Kaçiqi.

Është mirë të themi që në fillim, se poeti nisi të quhej "Kaçiq" mbas udhëtimit dhe qëndrimit të tij njëvjeçar në Venedik në 1751, ku ndenji bashkë me fratin tjetër Luka Vladimiroviq. (Në lidhje me mbiemrin "Kaçiq", mund të themi se në zanafillë përmendet si "Caceti" ose "Cacicli". Banorët që mbanin këtë mbiemër ishin piratë të famshëm nga Almissa, sot Omish, dhe deti Adriatik ishte plot me ta³³.) Që pikërisht Vladimiroviqi ai që e nxiti

30 Sirdani, Marin. "Të përtrimt e Patriarkatit serb në Pejë" tek *Hylli i Dritës*, 1924, nr. 10, fq. 398.

31 <http://hbl.lzmk.hr/clanak.aspx?id=267>. Konsultuar për herë të fundit më 17 shtator 2019.

32 Lulich vep. cit. fq. 49.

33 Selem, Alessandro. *Tommaso Arcidiacono e la storia medioevale di Spalato*, II edizione ampliata e con un appendice, Schönfeld, Zara 1933, fq. 38.

dhe i futi në gjak Kaçiqit dëshirën dhe interesin për “starine”, domethënë për ngjarjet historike të së kaluarës. Në këtë periudhë poeti krijoi edhe pemën gjenealogjike të familjes Kaçiq-Mioshiq. Para andej, ai nënshkruhej vetëm si “Mioshiq”. E në të vërtetë, Fra Karlo Eteroviq na përmend se pas qëndrimit njëvjeçar në Venedik, dy françeskanët zbarkuan në Zarë më 10 shtator 1752³⁴. Megjithatë, unë nuk mundem të pohoj se sa kohë qëndruan këtu dhe nëse është kjo periudha kur poeti dha mësim në Zarë pse, siç u tha më sipër, dokumentacioni është i pamjaftueshëm.

A ka mundësi që qyteti i Zarës, kryeqendër e Venedikut në Dalmaci, t’i ketë rrëfyer diçka me rëndësi shkrimtarit rreth luftimeve të arbërve kundër osmanëve? A mundet që këto rrëfime të kenë ndihmuar ta mbanin të gjallë interesin e *Plakut të Urtë Milovan* rreth arbërve, heronjve të tyre dhe të luftimeve të vazhdueshme të tyre kundër Portës së Lartë?

Tek “Biseda e këndshme” poeti citon autorin italian Brusoni si burim historik nga ka marrë të dhënat për trimëritë dhe lavditë e princave sllavë. Këto janë këngë tjera, që po ashtu, bëjnë pjesë tek kjo përmbledhje³⁵. Ky, Brusoni pra, është një historian mjaft i njohur i kohës i cili rrëfen ngjarjet e luftimeve të Kandies në një vepër të tijen botuar në vitin 1673³⁶. Me fjalë tjera, Kaçiqi e ka lexuar këtë libër, ashtu si edhe libra tjerë që flasin për këtë temë, nga të cilët ka nxjerrur të dhënat që i nevojiteshin për tekstet e shkurtra shpjeguese që i paraprijnë çdo kënge të “Bisedës”. Rreth luftës së Kandies, pastaj, do të flasë edhe tek vepra tjetër e tij “Korabljica” – *Anija*, ose, për ta përshtatur më mirë shqip “Arka e Noehit”, botuar në vitin 1760, pikërisht në atë mot kur edhe ndërroi jetë³⁷. Prap, edhe në këtë vepër, që nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e historisë së njerëzimit siç konceptohej asokohe, në pjesën e dytë, shkrimtari gjeti hapsirë për t’i kushtuar një “Kratko govorenje” – një *Rrëfim të shkurtër*, ngjarjeve të Skënderbeut³⁸.

Pikërisht në kishën e kuvendit françeskan në Zarë ku pati qëndruar Kaçiq-Mioshiqi, themeluar nga vetë ati serafik Shën Françesku i Asizit në 1212, janë të varrosur edhe disa nga stratiotët arbër që citon Brusoni. Rrasat e varreve të disave sish janë kopjuar nga botuar nga Atë Marin

34 Eterović, vep. cit., fq. 34.

35 Miljac, Miljenko. “Novovjeki pogled na epsko pjesništvo Fra Andrije Kačića Miošića” tek *Zbornik Kačić, br. 39-40 Kačić Miošić u Americi*. Split 2007. – 2008, fq. 156.


36 Brusoni, Girolamo. *Historia dell’ultima Guerra tra veneziani e turchi, nella quale si contengo i successi delle passate guerre nei regni di Candia, Dalmazia dall’anno 1644 all’anno 1671*, Venezia 1673.

37 Kačich, Andria. *Korabglicza pisma svetoga i svih vikovah svita dogagajjih poglavitih u dva poglavja razdigliena*, po Fra Andrii Kačichiu iz Brista, u gradu Veroni, iznova pritisctena, u Dubrovniku, po Antonu Martekini utiscteniku, 1833, fq. 492.

38 Po aty, fq. 453.

Sirdani (foto 1, 2) në revistën e njohur “Hylli i Dritës”, në 1922³⁹.

Nga këto rrasa, sot mund të shihet vetëm njëra, ajo me emrin e komandantit Gjon Gjini, (foto 3.)



(Foto 1)

39 Sirdani, Marin. “Besa e trimnija shqyptare”, tek *Hylli i Dritës*, nr. 8, 1922, ff. 372-382.

Pak mbrënda portës së shtëpisë, me vroshtë ne e rrmakët,
shifet një rrasë e hieshme me ketë perkujtim:

NEC MINVS FORTIS AC PII HEROIS
EPIROTICAE CLASSIS DVCTORIS
JOANNIS GINNI MEMORIA BINVM
IN AEBDOMADA SACRV PRO SVA ET
DOMINAE BELLE CONIVGIS DILECTISSIMAE
ANIMABVS QVADRAGENTORVM DVCATOR
CENSVS INSTITVENTES ET HOC
PRO INFIRMIS FRATRIBVS
EADEM D. BELLA MAEST. P. E.

Nen të më një rrasë, në të shtrime, është shkruar:

SEPVLTURA DE JOAN
NI GIGNI GOVERNA
TOR BENE MERITO DEL
LA SERENIS ma REFV-A
VENETA DI TVTTA
NATION ALBANESE
A SE E P. SVOI ERE
DI VIVENDO POSE

(Foto 2)



(Foto 3)

Mbasi që Atë Marin Sirdani i kishte kopjuar këto rrasa varresh, një dysHEME, të cilën ndoshta e kanë shtruar vetë françeskanët, pati mbuluar çdo varr brenda perimetrit të kishës. Në vitin 2011, zyra e Mirëmbajtjes së Monumenteve të Kulturës në Zyrë bashkë me françeskanët u detyruan nga lagështia ta hiqnin këtë dysHEME. Të çuditur vërejtën se nën të gjendeshin 123 rrasa varresh, gjë që është e kuptueshme, po të kemi parasysh vitin kur është ndërtuar kisha dhe që na tregon se as françeskanët dhe as Monumentet e Kulturës nuk kishin qenë në dijeni. Disa nga këto rrasa varresh tashti janë ekspozuar në klostrin e kishës françeskane, kurse të tjerat janë mbuluar prap nën një dysHEME të re (2011) që të mos dëmtohen. Para se t'i rimbulojë ama, Zyra e Mirëmbajtjes së Monumenteve të Kulturës i ka fotografuar të gjitha këto rrasa varresh dhe do t'i botojë në një katalog të saj. Këtë na e pohon një artikull i gazetës "Slobodna Dalmacija" e datës 16 shkurt 2011⁴⁰. Ndonjëra nga ato rrasa varresh që na intereson neve, siç është ajo e stratiotit Skura, ishte pjesërisht e fshirë nga motet, sikurse na dëshmon vetë Atë Marin Sirdani, ndoshta për shkak të vendndodhjes së saj.

Ndonëse kisha ishte plot me këso rrasa varresh, sikur ishte zakon asokohe, (mbase më pak se 123 në vitet e Kaçiqit), poeti kroat nuk mundet të mos i ketë vënë re këto të stratiotëve arbër, edhe sikur të ketë kremtuar Meshë një herë të vetme në këtë kishë: dy nga këto rrasa gjendeshin pikërisht në krahun e ungjillit dhe tjetra në krahun e epistolës, siç dëshmon Atë Sirdani. Stratiotët arbër, mes të cilëve edhe Gjergj Skura dhe shumë tjerë, përmenden shpesh nga Brusoni tek vepra e tij "Historia dell'ultima guerra"⁴¹.

Vijojmë më tej. Gjithnjë afër kishës së Shën Françeskut në Zyrë, familja e stratiotëve arbër *Renessi* [shqip: Rensi]⁴², kishte ngritur edhe një spital të vogël që mbante emrin e kësaj familjeje. Spitali u meremetua në vitin 1620 dhe ekzistonte ende në vitin 1877 kur kryediakoni Bianchi botoi librin e tij "Zara Cristiana"⁴³. Mund të dalim në përfundimin se kisha e Shën Françeskut e kuvendit françeskan në Zyrë ishte ajo e parapëlqyera e stratiotëve arbër, me sa duket. Kjo kishë, pastaj, është prap mjaft e rëndësishme për historinë e territoreve arbërore sepse në sakrestinë e saj, më 18 shkurt 1358 u nënshkrua paqja ndërmjet Fort të Kthjelltës Republikë të Venedikut dhe Mbretërisë së Hungarisë, paqe me të cilën Venediku u shtrëngua t'i jepte

40 <https://m.slobodnadalmacija.hr/kultura/clanak/id/124687/zadar-u-crkvi-sv-franc-pronaeni-zaboravljeni-grobovi>, konsultuar për herë të fundit më 20 janar 2020.

41 Brusoni, vep. cit., ff. 150-151.

42 Rreth familjes Renessi ka shkruar më gjerësisht prof. José M. Floristán: "Stradioti albanesi al servizio degli Asburgo di Spagna" tek *Shejzat-Pleiades*, nr. 1-2, 2019.

43 Bianchi, Carlo Federico. *Zara cristiana*, Zara 1877, fq. 521.

kësaj mbretërie bregdetin dalmat deri në Durrës⁴⁴.

Sa mund të ketë qenë numri i stratiotëve arbër në Zarë ose në rradhët e ushtrisë dhe të kalorisë venedikase do të përcaktohet nga kërkime tjera shkencore më të përpikta, por megjithatë dijmë me siguri se qysh në 1593, në Zarë nisën punimet për spitalin e ri, i cili, spitali ekzistues, në atë kohë quhej gjerësisht “Ospitale delle milizie italiane ed albanesi” – *Spitali i ushtarëve italianë dhe arbër*⁴⁵. Duke qenë se numri i ushtarëve u pat rritur, dhe jemi tashmë në 1700-in, asnjë meshtar nuk donte që të shërbente si kapelan aty, pranë këtij spitali. Kështu imzot Vinçenc Zmajeviqi, i cili tashmë ishte larguar nga Tivari dhe ishte emëruar në Zarë, ia besoi këtë detyrë dy fretërve kapuçinë që këta të kujdeseshin për të sëmurët⁴⁶.

Tjetër, gjithnjë rreth situatës kishtare në Zarë, në vitin 1675 ushtarët arbër dhe ata kroatë themeluan pikërisht në këtë qytet edhe Vëllazërinë (It. *Confraternita*) e Shën Jeronimit, shenjt të cilin e nderonin si bashkëatdhetar të tyre. Anëtarët e kësaj vëllazërie kujdeseshin për jetimët, iu siguronin pajën bijave të stratiotëve të vrarë në luftë, shpagueanin edhe hakun që osmanët kërkonin për stratiotët e zënë robër, etj⁴⁷. Vëllazëritë e këtij lloji në Zarë ishin gjallë deri në vitin 1808 kur u shpërbënë nga regjimi bonapartian.

Përsa i përket pastaj, prap, stratiotëve arbër në shërbim të Venedikut, këta i gjejmë të pranishëm në Shibenik, domethënë në Dalmaci, qysh në vitin 1423. Kështu, në një qarkore të autoriteteve më të larta venedikase urdhërohet kështjellari i Shibenikut që të zëvendësojë “tutti i soldati del detto castello e che hanno moglier paesane over albanese” – *të gjithë ushtarët e kësaj kështjelle dhe që i kanë gratë vendase, me fjalë tjera arbërore*, me harkëtarë, në mënyrë që kjo kështjellë të mos bjerret për fajin e një gruaje siç kishte ndodhur me atë të Ostrovicës. E njëjta gjë i urdhërohet kështjellarit të bëjë edhe me ushtarët e gjuhës sllave⁴⁸.

Më vonë pastaj, në 1548, përmendet si bazë ushtarake e stratiotëve, ndër të cilët bënin pjesë edhe ata arbër, ishulli i Shën Gabrielit (Insula San Gabrielis) i cili gjendet ndërmjet Prevlakës dhe Otok-ut, në jug të Kroacisë së sotme, afër Grykës së Kotorrit, në kufi me Malin e Zi⁴⁹.

Dimë gjithashtu se stratiotët arbër kishin kapelanët e tyre. Kështu Dom Pjetër Perlati, famullitar arbëror, del se e ka braktisur dioqezën e tij të Lezhës

44 Bogišić, V. et Jireček, C. *Monumenta Historico Juridica Slavorum Meridionalium. Liber Statutorum Civitatis Ragusii*, volumen IX, Zagabriae 1904, fq. XXVI.

45 Bianchi, vep. cit., fq. 346.

46 Po aty, fq. 522.

47 Po aty, fq. 346.

48 Ljubić, Sime. „God. 1423. 17. srpnja u Mletcih“, tek *LISTINE*, knjiga VIII, od godine 1420 do 1424, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Zagreb 1886, fq. 240.

49 Madirazza, Francesco. *Storia e costituzione dei comuni dalmati*, Spalato 1911, fq. 313.

dhe ka shkuar në Zarë për të shërbyer pikërisht si kapelan i ushtarëve arbër. Kështu pohohet në një relacion të vitit 1679 të imzot Vladanajt, ipeshkëv i Lezhës, dërguar Kongregatës së Shenjtë të Propagandës Fide në Romë⁵⁰.

Prania e stratiotëve në Zarë, për të cilën po flasim nuk ishte pra e rastësishme dhe zgjat disa shekuj. Këta luftëtarë i gjejmë të pranishëm në të gjithë bregdetin e Adriatikut, nga Ulqini e deri në Zarë. Në Zarë dhe në Shibenik, emrat e tyre dalin vazhdimisht. Kështu, sa për të dhënë ndonjë nga dokumentet e panumërta që gjejmë për ta: në 1520 përmenden Meksha, Teodor Maneshi; në Budua del Gjergj Bua në 1527. Një tjetër prijës i stratiotëve që na del është Gjergj Buzuku në vitin 1523. Prap, luftëtari prijës stratiot Stamat Luzi del në Zarë, në vitin 1524. Të gjitha këto të dhëna na i dëshmojnë ditarët e historianit italian Marino Sanuto⁵¹.

Petani dhe Kamsi

Në gjysmën e parë të shtatëqindshit, ipeshkvi Vincenc Zmajeviq, i cili tashmë ishte dërguar në Zarë, themeloi kolegjin ilirik [në gjuhën kroate], por ndërroi jetë para se të çelej. Si pro-rektor i seminarit ilirik në Zarë u emërua nga kryeipeshkvi *Caraman*, mbasardhës i Zmajeviqit, Dom Gjon Petani, ish-nxënës i Kolegjit të Propagandës Fide në Romë, meshtar arbëror i familjes Petani, mbërritur në Zarë në vitin 1726. Më vonë, Petani u bë rektor i Kolegjit Ilirik të Loretit⁵². Një degë e familjes Petani jeton ende sot në Shkodër.

Në ato vite, erdhi nga Italia edhe Gjon *Kamsi*, i cili më pas u zgjodh, gjithnjë nga Zmajeviqi, kanonik i kapitullit të Zarës në 1730. Kamsi kishte lerë në Shkodër, ku, edhe kjo familje gjendet ende sot e kësaj dite dhe ka zanafillë të vjetër.

Ish-nxënës i Kolegjit të Loretit, Kamsi u prit fort ngrohtësisht sadoqë ishte i huaj dhe zgjuarsia e tij nuk kaloi pa rënë në sy, aq sa i vlejti edhe emërimin ipeshkëv i Shkodrës në 1739 nga papë Klementi XII. Megjithatë Kamsi, sadoqë Zmajeviqi vazhdonte ta luste ta pranonte emërimin dhe të shkonte në Shkodër, nuk pranoi, dhe ndenji në Zarë deri në fund të jetës së tij⁵³. Vdiq në vitin 1777, në moshën 90-vjeçare dhe u varros në kapelën e Shën Anastazies në katedralen e Zarës. Kur kjo kapelë u riparua, eshtrat e tij mbetën nën dyshtemenë e re që u shtrua⁵⁴.

50 Bartl, Peter. *Albania Sacra, Geistliche Visitationberichte aus Albanien, 1: Diözese Alessio, Albanische Forschungen* 26, 1, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden 2007, XII, fq. 129.

51 Sakcinski, Ivan Kukuljević (uredio). *Arkiv za povjestnicu Jugoslavensku, knjiga VIII*, u Zagrebu i u Mletcih 1865, ff. 69-73, 83, 87, 146, 163, 188, 237-238.

52 Bianchi, vep. cit., fq. 270.

53 Po aty, fq. 221.

54 Po aty, fq. 105.

Këtyre dy kontakteve më se të mundshme të Kaçiq-Mioshiqit me prelatë arbër nuk mund të mos i shtojmë edhe ato me bashkësinë arbanase të lagjes *Arbanas* dhe Zemunik etj, që kishte ardhur në Zarë me dy a tri shpërngulje⁵⁵. Mbetet për t'u hulumtuar gjithashtu nëse këta kishin sjellë me vete edhe ndonjë këngë kushtuar Skënderbeut.

Françeskanët Filip Grabovac, Andrija Kačić-Miošić dhe Filip Lastrić Oćevac

Këta tre françeskanë, mjaft të njohur për historinë dhe letërsinë kroate dhe boshnjake, sollën figurën e Skënderbeut në historinë kroate (Grabovac), në letërsinë kroate (Kaçiq-Mioshiq) dhe ky që i pari që e solli masivisht, si edhe në leteraturën e llojit teologjiko-katekistik (Lastriq). Më pas, në historinë dhe letërsinë e sllavëve të jugut, Skënderbeu do të mbetej një figurë e njohur.

Dy të parët tërhiqen shumë nga përmasat historike, politike dhe diplomatike të Gjergj Kastriotit. Ndërsa françeskani tjetër, Filip Lastriq, nga Bosnja, e përcolli figurën e Skënderbeut për herë të parë në një kontekst krejt tjetër: në atë teologjik. Lastriq, i cili njihet edhe si Filip Oqevac, që një figurë mjaft e rëndësishme e françeskanizmit boshnjak. Mjafton të themi se ka bashkëpunuar, me korrespondencë, në hartimin e vëllimit të katërt të "*Illyricum Sacrum*" të Farlatit⁵⁶.

Ky autor tek "*Nediljnik Dvostruk*" – një vepër me karakter doktrinor katolik – përpqet t'u shpjegojë lexuesve çfarë është dhe si vepron fuqia e Zotit, dhe bën këtë duke marrë si shembull Skënderbeun. Për këtë, përmend dy ndodhí nga jeta e Kastriotit:

[...] Ma kakve scynite daŭu muke ũ paklu? Ako upitamo Jerolima, odgovarah: u onom miŭtu od mukah jest, vatra ſumpor, ſmrad, czarvi, zmie, skorpion, xaloŭti, viçgne, muka viçgnja, &. c. Ako upitamo S. Ivano Zlatowŭtoga, odgovarah: u pakluje zyma, priltdena, vatra priuxgana, czarv koi neumira, s'mrad koife podnit nemore. Ma ſvakaŭu ova alat deŭnice Boxie, iliti pravde; alat doifto toliko jaççe, dilluje kolikoje ũ ruci jaçoj i izvarsnityoj. Sh jefe u xivotu glaŭovitoga viteza Kaŭhtriotichja, koga mloghi zovu Kaender begom, da ovi imadiŭhe maç, koizim kadmu drago jednoç famo mannuvŭshi, kakvuti drago voluvratbi priŭfikao, i varknulabimu gláva. Çuvŭshi ovo Czar Sultan Muhamed drughi, poruçi damu ovi maç poŭagle, i poŭla muga; Al nemoguchi nikto one ŭlave imate, da mannuvŭshi gniŭ jednoç odsyçe volu glavu, poŭsumgliŭhe da nie onog iŭtoga maça poŭlao: ŭhto çuvŭshi Kaŭhtriotich, reççe: poŭluoŭam maç, al niŭam deŭnice moje: poçemu ottje

55 Čurković, Don Mijo. *Povijest Arbanasa kod Zadra*, E. Vitaliani, Šibenik 1922, fq. 4; 6-7.

56 Mlivoŭčić, Ivica. "Fra Filip Lastrić Farlatijev ŭradnik", tek *Zbornik o Fra Filipu Lastriću Oćevcu u povodu 300 obljetnice rođenja*, priredio Simun Musa, Mostar 2000, fq. 153.

zlamenovati, da alat, i oruxje, kolikoje ù ruci jaçoj, i kriпки – joj, toliko jaçe, i fñaxnie dilluje? Sado promislite, ima da ogagn, zyma; glad, xegja, fumpor, fmrad, czarvi, zmie, skorpion, zapuaçe xabe: &c. ù paklu, nefamo onu snagu naravnu, kakono na ovom fvytu imajuh muçiti tilefa gluska, nego imaju snagu svarhuravnu ú paklu muçiti i tilefa i dushe; kakonoti ala i oruxje prijake defñice Boxie, iliti pripravedne farçbe gnegove, zashto tko ù ono nesrichno nifto ottigae, farçha Boxia pribiva fvarhu gnega, veli Gospodin (d) Anaosftriche tvardu farçbu za fuliczu.[...] ⁵⁷.

Këto dy episode na sjellin ndërmend zulmën dhe rëndësinë e shpatës së quajtur “Durlindana” të Orlandit të Furishëm, të Ariostos, por këtë herë, heroi që e vringëllin gëzon një famë të padiskutueshme dhe, ndryshe nga kalorësi Marko Kraljeviq, nuk i jep shumë rëndësi armës. Atë Lastriqi iu rrëfen lexuesve këto dy tregime për t’i shpjeguar se në vuajtjet e Ferit, i Lumi mund të përdorë edhe diçka krejt të vogël dhe të parëndësishme për të shkaktuar vuajtje tepër të mëdha e që nuk mund të merren me mend, sepse gjithçka varet si përdoret nga Zoti, ashtu sikurse në rastin e Skënderbeut, palla e tij ndonëse e një llojit krejt të zakonshëm, kur e vringëllinte ai bënte kërdrnë.

Nëse krahasimi i Lastriqi ishte i qëlluar teologjikisht apo jo, do t’ua lëmë teologëve ta gjykojnë.

Këto dy rrëfime rreth Kastriotit që përmend Atë Lastriqi ishin botuar

57 [...] por cilat çmoni ju se janë mundimet në ferr? Nëse do të pyesnim Hieronimin do të na përgjigjej: në atë vend mundimesh ka zjarr, squfur, qelbësirë, krimba, gjarpërinj, akrepë, dhimbje, ulërma, britma nga dhimbjet e kështu me radhë. Nëse do të pyesnim Shën Gjon Gojartin, do të na përgjigjej: në ferr ka dimër, ngricë, zjarr përvëlues, krimba që nuk të lenë të qetë, qelbësirë të padurueshme. Por të gjitha këto janë gjëra të së dhathtës së Zotit, ose të së Vërtetës. Një send i fuqishëm është më i fuqishëm sa më e fuqishme dhe e përkryer të jetë dora [që e përdorë]. Kjo ndodhi në jetën e zulmëmadhit kalorësit Kashtriotiq, të cilin shumë e quajnë Skënder Beg, dhe se ky kishte një pallë me të cilën, kurdoherë që të dëshironte, vetëm me një të rënë, cilindo buall do t’a priste, dhe buallit do t’i rrokullisej koka. Kur e dëgjoi këtë Sulltan Mehmeti II, i çoi fjalë që t’ia dërgonte këtë pallë, dhe ky ia dërgoi. Por duke qenë se askush nuk arriti të fitonte me të po aq lavdi [sa Skënderbeu], që me një të rënë t’i priste kokën buallit, dyshoi se mos nuk i kishte dërguar të njëjtën pallë. Kur e dëgjoi këtë Skënderbeu, tha: dërgova pallën por jo të dhathtën time: kjo gjë na dëfton se një send, dhe armë, sa më e fortë dhe e fuqishme të jetë dora, aq më e fortë dhe fuqishëm vepron kjo. E tashti mendoni zjarri, dimri, vapa, squfuri, qelbësira, krimbat, gjarpërinjtë, akrepët, thithlopat dhe tjera, në ferr nuk kanë vetëm forcën e tyre të natyrshme, atë që kanë në këtë botë për t’iu shkaktuar mundime trupave njerëzorë, por kanë një forcë të jashtëzakonshme në ferr për të munduar trupat dhe shpirtrat, ashtu si edhe sendet dhe armët në të dhathtën tepër të fuqishme të Zotit, të zemërimit tepër të drejtë të tij, dhe kush niset për në atë vend të mjerë, zemërimi i Zotit i bie mbi kokë, thotë Zoti, dhe [Ai] do ta mprehtë edhe më shumë zemërimin e tij kundër [mëkatorit?]. [...] tek: Lastrić, Fra Filip. Nediglnik Dvostruk, v Mletzij 1766, ff. 390-391.

që më parë në një përmbledhje të autorit italian Nicolo Granucci⁵⁸. Të dy këto tregime vënë në dukje fuqinë dhe urtinë e Kastriotit, dhe po të gjykosh nga patosi që i karakterizon, duket se kanë buruar dhe janë mbajtur gjallë në mesin e ushtarakëve, siç mund të jetë ambjenti i stratiotëve, fjala vjen.

Është e rëndësishme të vihet në dukje se legjenda dhe rrëfime të tilla anekdotike si këto që rrëfen Lastriqi, janë mbledhur nga autorë të ndryshëm në Shqipëri. Ndër këta, përmendim edhe veprën “Skënderbeu mbas gojëdhanash” të Atë Marin Sirdanit⁵⁹, ku përfshihen edhe dy tregimet që përmend Lastriqi. Disa nga këto rrëfenja të mbledhura nga Sirdani kanë në qendër të tyre plakun e urtë Kokë Malçi [Malshi], i familjes Skura të Kurbinut, pikërisht nga ai fis nga vinte edhe stratioti Gjergj Skura, epitafin e varrit të të cilit e pamë të projektuar. Urtia e Kokë Malçit, tek këto rrëfenja, e befason disa herë Skënderbeun.

Përkthimet shqip të këngëve të Kaçiq-Mioshiqit kushtuar Skënderbeut

Të vetmet përkthime në gjuhën shqipe të disave prej këtyre këngëve iu përkasin viteve 1900-1901. Përkthyesi është Atë Pashk Bardhi o.f.m. dhe këngët janë botuar tek revista “Albania” e Faik Konicës. Fratit iu desht t’i botonte këngët nën emrin e rremë “Vorf Dukaghini” përndryshe do t’i dilnin telashe me autoritetet osmane të cilat nuk e njihnin shtypin në gjuhën shqipe dhe përndiqnin këdo që shkruante shqip. Përkthyesi ruhej, sadoqë në vitet 1901-1905 gjendej në kuvendin françeskan të Zarës dhe ndërkaq jepte mësim në shkollën shqipe të *Arbanasit*.

Ja këtu një listë e përkthimeve të tij:

1. Lufta é Skandér bégut kunnra Ali pashes n’ vjéte 1443, Albania 1900, nr. 2, ff. 56-58.

2. Lufta é Skandér bégut kunnra Ali pashes n’ vjéte 1443, Albania 1900, nr. 3, ff. 68-69.

3. Létra qi i shkroi rhéghi i Ungariis Ghérgh Kastriotit n’viéte 1443, Albania 1900, nr. 7, ff. 134-136.

4. Martésa é Mamitses motres t’Skandér-bégut, Albania 1901, nr. 1, fq. 11.

5. Lufta é Ghérgh Kastriotes mé républike t’Vénédikut n’vjéte 1447, Albania 1901, nr. 9, ff. 137-138.

58 Granucci, Nicolao. *Opera nella quale si contengono novelle; con un breve compendio de’ fatti più notabili de’ Turchi, sin’ a tutto l’anno 1566. La vita del Tamburlano, di Scanderbeg, l’origine de’ Cavalieri Hospitalari di Gierusalen & la Descrizione dell’Isola di Malta. Con la tavola delle cose più notabili*, Lucca 1569, libro secondo, foglio 67. [Falenderoj Prof. Matteo Mandalà për këtë sinjalizim.]

59 Sirdani, Marin. *Skanderbegu mbas gojëdhanash*, shtypshkroja françeskane, Shkodër 1926, ff. 43-44.

Krahasuar me “Razgovor Ugodni” (1983), botim i kujdesuar nga Atë Hrvatin Gabrijel Jurišić o.f.m.⁶⁰, përkthimet e mësipërme shqip iu përgjigjen këngëve të mëposhtme:

- 24. Rat Jure Kastriotića i Cara Murata 1443, fq. 121.
- 24. Rat Jure Kastriotića i Cara Murata 1443, [pjesa e dytë].
- 25. Kralj Ugarski i Jure Kastriotić, fq. 125.
- 27. Udaja Mamice, sestre Jure Kastriotića, fq. 130.
- 28. Rat arbanasa s Mletačkom Republikom 1447, fq.131.

Siç mund të shihet nga analiza e teksteve, bëhet fjalë për vetëm katër këngë, të cilat, më shumë se përkthyer, janë përshtatur në gjuhën shqipe. Pas Atë Pashk Bardhit, asnjë tjetër nuk është marrë më me përkthimin e këngëve të tjera të Kaçiqit kushtuar Gjergj Kastriotit. Mbasi u fitua pavarësia, shqiptarët filluan ata vetë të prodhonin vepra letrare, dhe jo vetëm, kushtuar Skënderbeut.

BIBLIOGRAFI

- BARLETIUS, Marinus. *Historia de vita et gestis Scanderbegi, epirotarum principis*. Bernardino Vitali, Roma 1508.
- BARTL, PETER. *Albania Sacra, Geistliche Visitationberichte aus Albanien, 1: Diözese Alessio, Albanische Forschungen 26, 1*, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden 2007
- BIANCHI, Carlo Federico. *Zara cristiana*, Zara 1877.
- BLANCUM, per Franciscum. *Georgius Castriottus, Epiroensis vulgo Scanderbeg, Epirotarum princeps Fortissimus, ac invictissimus Suis & Patriae restitutus*, Venetiis, typis Marci Ginammi, 1636.
- BOGIŠIĆ, V. et JIREČEK C. *Monumenta Historico Juridica Slavorum Meridionalium. Liber Statutorum Civitatis Ragusii*, volumen IX, Zagabriae 1904.
- ČURKOVIĆ, Don Mijo. *Povijest Arbanasa kod Zadra*, Vitaliani, Šibenik 1922.
- ETEROVIĆ, Fra Karlo. *Andrija Kačić Miošić na temelju novih istraživanja*, Dubrovnik 1922.
- FABIANICH M.O., padre Donato. *Storia dei frati minori dai primordi della loro istituzione in Dalmazia e Bosnia*, vol. I, Zara 1863.
- FLORISTÁN, José M. “Stradioti albanesi al servizio degli Asburgo di Spagna” tek *Shejzat-Pleiades*, nr. 1-2, 2019.

60 Jurišić, Hrvatin Gabrijel (glavni urednik). *Fr Andrija Kačić-Miošić, Razgovor Ugodni naroda slovinskoga*, Split 1983.

- GRANUCCI, Nicolao. *Opera nella quale si contengono novelle; con un breve compendio de' fatti più notabili de' Turchi, sin' a tutto l'anno 1566. La vita del Tamburlano, di Scanderbeg, l'origine de' Cavalieri Hospitalari di Gierusalem & la Descrittione dell'Isola di Malta. Con la tavola delle cose più notabili*, Lucca 1569.
- <http://hbl.lzmk.hr/clanak.aspx?id=267>. Konsultuar për herë të fundit më 17 shtator 2019.
- <https://m.slobodnadalmacija.hr/kultura/clanak/id/124687/zadar-u-crkvi-sv-frane-pronaeni-zaboravljeni-grobovi>. Konsultuar për herë të fundit më 20 janar 2020.
- JURIŠIĆ, Hrvatin Gabrijel. (glavni urednik), *Fr Andrija Kačić-Miošić. Razgovor Ugodni naroda slovinskoga*, Split 1983.
- KAČICH, Andria. *Korabglicza pisma svetoga i svih vikovah svita dogagajjih poglavitih u dva poglavja razdigliena*, po Fra Andrii Kačichiu iz Brista, u gradu Veroni, iznova pritiscstena, u Dubrovniku, po Antonu Martekini utiscstenu, 1833.
- KASANDRIĆ, P. (scelti e tradotti da). *Canti popolari serbi e croati*, Carabba editore, Lanciano 1923.
- LASTRIĆ, Fra Filip. *Nedignik Dvostruk*, v Mletczij 1776.
- LJUBIĆ, Sime. *Listine*, knjiga VIII, od godine 1420 do 1424, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Zagreb 1886.
- LULICH, padre Antonio. *Stato della Dalmata Francescana Provincia del MM. OSS del SS Redentore*, Spalato 1857.
- MADIRAZZA, Francesco. *Storia e costituzione dei comuni dalmati*, Spalato 1911.
- MATIĆ, Tomo. (priređio). *Cvit razgovora naroda i jezika iliričkoga aliti rvačkoga*, Jugoslavenska Akademija znanosti i umjetnosti, priredio, Zagreb 1951.
- MILJAC, Miljenko. "Novovjekni pogled na epsko pjesništvo Fra Andrije Kačića Miošića" tek *Zbornik Kačić br. 39-40 Kačić Miošić u Americi*. Split 2007. – 2008.
- MLIVONČIĆ, Ivica. "Fra Filip Lastrić Farlatijev suradnik", tek *Zbornik o Fra Filipu Lastriću Očevcu u povodu 300 obljetnice rođenja*, priredio Simun Musa, Mostar 2000.
- MURAJ, Lada. "Dva lica kućnoga kazališta u Dubrovniku u 18. stoljeću", tek *Croatologija* 1(2010) 1.
- NEZIRI, Zeqirja. *Lik Skenderbega u djelu Andrije Kačića-Miošića*, magistarska radnja, Filozofski Fakultet, Zagreb 1981.
- PERILLO, Francesco Saverio. "Andrija Kačić-Miošić i povijest." tek *Fra Andrija Kačić Miošić i kultura njegova doba: zbornik radova sa znanstvenog skupa Fra Andrija Kačić Miošić i kultura njegova doba*, održanoga 3. - 7. studenoga 2004. u Zagrebu, Sinju, Makarskoj, Mostaru, Bristu i

- Zaostrogu, Hrvatska akademija znanosti i umjetnosti, Zagreb 2007.
- SAKCINSKIJ, Ivan Kukuljević. (uredio). *Arkiv za povjestnicu jugoslavensku*, knjiga VIII, u Zagrebu i u Mletcih, 1865.
- SELEM, Alessandro. *Tommaso Arcidiacono e la storia medioevale di Spalato*, II edizione ampliata e con un appendice, Schönfeld, Zara 1933.
- SELLA, Pacifico. Testimonianze inedite circa il martirio dei frati minori Giacomo da Sarnano e Ferdinando da Albissola, *CARTHAGINENSIA*, VOL. XXXI, 2015.
- SIRDANI, Marin. "Besa e trimnija shqyptare", tek *Hylli i Dritës*, 1922, nr. 8.
- SIRDANI, Marin. "Të përtrimt e Patriarkatit serb në Pejë" tek *Hylli i Dritës*, 1924, nr. 10.
- SIRDANI, Marin. *Skanderbegu mbas gojëdhanash*, shtypshkroja françeskane, Shkodër 1926.
- TOMMASEO, Niccolo. *Canti popolari serbo-croati*, prefazione di Gheorghe Carageani, Sansoni editore, Firenze 1992.
- VONČINA, Josip. *Razgovor Ugodni Naroda Slovinskoga, Andrija Kačić-Miošić – Satir ili divlji čovik*, Matija Antun Reljković, Zagreb 1988.